

## ORGANET KOMPETENTE PËR REGJISTRIM TË PRONËS

Bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, organe kompetente për regjistrimin e të drejtave pronësore janë Zyrrat Kadastrale Komunale, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës është organ i nivelit qendror i shkallës së dytë, në cilësinë e organit për ankimim.

## LLOJET E TË DREJTAVE PRONËSORE PËR REGJISTRIM

Procedurat për aplikim dhe regjistrim të të drejtave pronësore dallojnë varësisht të drejtës që regjistrohet, e ato janë si vijojnë:

- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME AKTVENDIM TRASHËGIMIE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE ,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM GJYQSORË,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM NGA ORGANET TJERA KOMPETENTE,
- REGJISTRIM I PRONËSISË ME KREDITIM APO HIPOTEKË,
- BARTJE E PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDËRTIM/KOMPENSIM,
- BARTJE E PRONËSISË NË BAZË TË PRANIMIT,
- REGJISTRIM I KONTRATËS ME MBAJTJE TË PËRHERSHME.

## PRONËSIA ËSHTË E DREJTA E TËRËSISHME NË NJË SEND

Pronari mund të disponojë pronën e tij sipas dëshirës së tij, nëse kjo nuk kundërshtohet nga një palë e tretë ose nga ligji.

Për bartjen e të drejtës mbi paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme e ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Vetëm atëherë mund ta vërtetohet pronësia me anë të certifikatës së pronësisë.

Bazuar në këtë që u tha më sipër llojet e bartjes së të drejtës së pronësisë që regjistrohen në SIKTK janë:


- BLERJA,
- TRASHËGIMIA,
- DHURIMI,
- KËMBIMI,
- NDARJA FIZIKE,
- SHPRONËSIMI,
- VENDIM GJYQËSOR,
- VENDIM NGA ORGANET KOMPETENTE,
- KREDITIM/HIPOTEKË,
- NDËRTIM/KOMPENSIM,
- NË BAZË TË PRANIMIT DHE
- MBI MBAJTJEN E PËRJETSHME.

Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Rr: "Arbnor dhe Astrit Dehari" Nr. 25  
10000  
Pristinë  
Republika e Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Katastarska Agencija Kosova  
Kosovo Cadastral Agency

## PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR



## REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDARJE FIZIKE TË PRONËSISË



## PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDARJE FIZIKE TË PRONËSISË

Një kontratë mbi ndarjen fizike të pronësisë nënkupton kontratën e cila lidhet ndërmjet pronarëve të disa pronave të cilët merren vesh që të ndajnë ato prona mes tyre.

Për shembull nëse në tre parcela të ndryshme ka tre bashkëpronarë ata mund të merren vesh që secili nga ta të bëhet pronarë i vetëm njëjës prej tyre.



Është e rëndësishme të theksohet që ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, e njeh të drejtën e pronësisë vetëm pas regjistrimit të saj në regjistër. Pra pronari i ri të drejtën e tij/saj mbi pronën e paluajtshme mund ta gëzojë vetëm pas regjistrimit të saj në emrin e tij/saj në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP).

## DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË KËMBIMIT

Lidhja e kontratës për ndarje fizike të pronësisë mund të bëhet tek noteri apo në gjykatën përkatëse, sipas kompetencës territoriale ku ndodhet prona. Palët e interesuara për ndarjen fizike të pronësisë duhet që para noterit apo në gjykatë të prezantojnë dokumentet e më poshtme:



- DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT TË TË GJITHË PRONARËVE OSE CERTIFIKATËN E BIZNESIT PËR PERSONA JURIDIK (KOPJE),

- CERTIFIKATËN E PRONËSISË (ORIGJINAL DHE JO MË E VJETËR SE GJASHTË MUAJ) DHE

- KOPJEN E PLANIT (ORIGJINAL DHE JO MË E VJETËR SE GJASHTË MUAJ).

## DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE

Pas marrjes së aktvendimit tek noteri apo në gjykatë, me qëllim të ekzekutimit të tij në kadastër, pala duhet të kompletojë dokumentacionin si më poshtë:

- KËRKESA E PALËS,

- NJË KOPJE TË KONTRATËS PËR NDARJE FIZIKE TË NOTERIZUAR,

- DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT TË TË GJITHË PRONARËVE OSE CERTIFIKATËN E BIZNESIT PËR PERSONA JURIDIK (KOPJE),

- CERTIFIKATËN E PRONËSISË (KOPJE),

- KOPJEN E PLANIT (KOPJE),

- DËSHMINË E PAGESËS SË TARIFËS PËR REGJISTRIM DHE

- DOKUMENTE TJERA SHITESË (NËSE KËRKOHET NGA ZKK, SI P.SH. TATIMI NË PRONË, ETJ).

